

S T A T U T I
I
SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“RXH GENERAL SERVICES” SH.P.K.

KREU I PARE
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Formimi i Shoqerise

NENI 1

Shoqeria Tregtare “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k, me seli qendrore ne adresen Njësia Administrative Nr. 6, Rruga Thoma Koxhaj, Pallatet “Agolli”, Kati 1, Dyqani Nr.2, Kodi Postar 1027; Tiranë formohet nga ortakut themelues Nuriana Isufi

E cila me vullnetin e saj te lire dhe ne perputhje me Ligjin Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, si dhe Aktin e Themelimit, ka vendosur te destinoje ne kete Siper marrje kapitalin e saj, me qellim qe te perfitojne te ardhurat qe mund te vijne nga veprimtaria private e Shoqerise, si dhe te perballoje humbjet deri ne kufirin e vleres se kontributit ne Kapitalin Themeltar.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne baze te ekonomise se tregut te lire. Shoqeria tregtare “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k, fiton Personalitet Juridik nga dita e rregjistrimit te saj prane zyres se Qendres Kombetare te Biznesit.

Forma, Emertimi,

NENI 2

1. Shoqeria tregtare, eshte e organizuar si Shoqeri Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar.
2. Emertimi i Shoqerise eshte: “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k.
3. Ne rast transferimi te veprimtarise tregtare, mund te ruhet i njejti emertim, me kusht qe Personi Juridik te shtojte ne kete emertim nje shenim i cili ka te beje me transferimin.

Selia, Territori

NENI 3

1. Shoqeria Tregtare “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k, ka seline qendrore ne territorin e Republikes se Shqiperise Njësia Administrative Nr. 6, Rruga Thoma Koxhaj, Pallatet “Agolli”, Kati 1, Dyqani Nr.2, Kodi Postar 1027; Tiranë
2. Shoqeria mund te krijojte qendra sekondare, filiale, zyra perfaqesimi apo agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.
3. Ajo mund te jete pjesemarrrese ne nje shoqeri tregtare apo mund te kontrolloje shoqeri te tjera tregtare si brenda dhe jashte territorit te Republikes se Shqiperise.
4. Njesite strukturore te shoqerise ne format e mesiperme do te krijohen ne perputhje me legjislacionin Shqiptar kur ndodhen brenda territorit te Republikes se Shqiperise, dhe jashte saj ne perputhje me legjilacionin e vendit ku Personi Juridik ka qendren e vet.
5. Shoqeria do te kete vullen e saj.

Kohezgjatja

NENI 4

1. Shoqeria Tregtare “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k, do te permbushet objektin e veprimtarise se vet me nje afat te pacaktuar.
2. Ndryshimet e shoqerise duke perfshire edhe percaktime te mevonshme ne lidhje me kohezgjatjen e aktivitetit te saj nuk sjellin si pasojte krijimin e nje Personaliteti Juridik te ri.

Objekti

NENI 5

Shoqeria Tregtare “RXH GENERAL SERVICES” sh.p.k, ka si objekt veprimtarie:

Kembim valutor. Transferte parash. Shitje e blerje çeqesh, monedha te metaleve fisnike. Ushtrim i veprimtarisë së transferimit të parave në emër dhe llogari të nje subjekti financiar jo-bankë. Rimbushje dhe pagesa elektronike. Shitje me pakice te aksesoreve te ndryshem. Agjent i shoqerise EasyPay Sh.p.k. (Institucion i Parase Elektronike), per kryerjen e sherbimeve qe perfshijne po nuk kufizohen ne pagesa faturash, shitje te mallrave/sherbimeve te partnereve te EasyPay.

NENI 6

Shoqeria tregtare "RXH GENERAL SERVICES" sh.p.k, nuk pergjigjet per detyrimet qe rrjedhin nga veprimtaria ekonomiko-tregtare apo industriale qe ortaket zhvillojne ne menyre te pavarur prej saj.

Kapitali

NENI 7

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar eshte **100.000 (njqind mije) Leke**. 1 (nje) kuote gjithsej.

Ortaku i shoqerise eshte:

1. **Nuriana Isufi**, zotërues i 1(nje) kuote me vlere 100.000 leke, qe perfaqeson **100% (njqind %)** kapitalin themeltar të shoqërisë;

NENI 8

Shoqeria krijon fondin rezerve dhe fonde te tjera te veçanta te financimit per zhvillimin ekonomik e tregtar.

NENI 9

1. Perberja e kapitalit te shoqerise, fondet e krijimit te saj si dhe perdorimi e rregullimi i çdo fondi te veçante percaktohen nga ortaku sipas te drejtave dhe detyrave te percaktuara ne statut.
2. Te ardhurat e pergjitheshme te shoqerise dhe ne pergjithesi çdo operacion financiar i saj do te pasqyrohet ne kontabilitetin e shoqerise sipas legjislacionit ne fuqi dhe ne mbeshtetje te akteve perkatese te rrjedhura prej tij.
3. Te ardhurat neto qe do te rezultojne nga bilanci i miratuar nga Vendimi i Ortakut do te shperndahen si vijon: 5 % per fondin rezerve, deri sa ky fond te arrije 1/5 e kapitalit themeltar; ndersa pjesa tjetere ortakut te saj ose do te shtohet ne kapital.

NENI 10

1. Shoqeria Tregtare "RXH GENERAL SERVICES" sh.p.k, eshte pronare e pasurise se saj te cilen e perdor dhe e disponon ne emer te saj ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise se shoqerise.
2. Shoqeria eshte e lire te bleje dhe te shfrytetoje te drejta te tjera materiale ne perputhje me legjislacionin perkates shqiptar.
3. Te gjitha shpenzimet per ushtrimin e aktivitetit tregtar, asistence teknike e juridike paguhen nga fondet e shoqerise.

NENI 11

1. Pasurite e shoqerise vleresohen ne monedhe shqiptare.
2. Aktiviteti financiar i shoqerise do te mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti dhe bilanci do te miratohet brenda tre muajve te vitit ne vazhdim.
3. Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar, raportet e veçanta te hartuara nga Ortaku dhe eventualisht nga eksperti i autorizuar miratohen me Vendim te Ortakut te saj.

NENI 12

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie. Ato jane lirisht te transferueshme edhe ne rast ndarje pasurore midis bashkeshorteve si dhe ndermjet pasardhesve dhe paraardhesve.

NENI 13

Transferimi i pjeseve te kapitalit themeltar me trashegimi ose brenda familjes personave perfitues do te behet pasi ata te pranojne permbajtjen e statutit te kesaj shoqerie tregtare me gjithe ndryshimet qe ai mund te kete pësuar deri ne momentin qe keto pjese te kapitalit themeltar behen te transferueshme.

NENI 14

Ne rast mospranimi, pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri vetem me miratimin e Ortakut.

NENI 15

Zmadhimi i kapitalit themeltar me anen e kontributeve ne para dhe ne natyre apo zvogelimi i tij behet me Vendimin e Ortakut te shoqerise mbi bazen e nje projekti te paraqitur nga eksperti kontabel i autorizuar.

KREU I DYTE

Ortakeria

NENI 16

Ortaku i shoqerise tregtare "RXH GENERAL SERVICES" sh.p.k, gezon te gjitha te drejatat dhe marri persiper detyrimet qe pasqyrohen ne legjislacionin e Republikes se Shqiperise, ne Aktin e Themelimit dhe ne Statutin e Shoqerise.

Te drejatat dhe detyrat e Ortakut

NENI 17

1. Te marre pjese ne mbledhjet e Asamblese se Ortakut duke ushtruar te drejten e votes se saj;
2. Te paraqese pyetje me shkrim ne lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqerise ndaj administratorit;
3. Te informohet mbi permbajtjen e raportit te administrimit, inventaret e llogarite vjetore, tekstet e vendimeve te propozuara, dhe raportin e ekspertit kontabel;
4. Te perfitoje nga fitimi i shoqerise;
5. Te kerkoje prishjen e shoqerise ne rrethana te caktuara;

KREU I TRETË

Administrimi i Shoqerise

NENI 18

1. Shoqeria do te administrohet nga administratori **Ergys Dervishi**, i cili perfaqeson shoqerine ne marredheniet me te tretet per nje periudhe **5 (pese)** vjecare dhe me te drejte rizgjedhje.
2. Administratori mund t'i delegoje kompetencat e tij me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
3. Shoqeria ne te ardhmen mund te administrohet dhe nga nje administrator tjetër, i cili emerohet me Vendim te Ortakut.

Asambleja

NENI 19

1. Asambleja e Ortakut eshte organi me i larte vendimmarres i shoqerise.
2. Ortaku mund t'i delegojne kompetencat e saj me shkrim ne formen e autorizimit ose me prokure.
3. Çdo klauzole e kundert eshte e pavlefshme ne kete rast.

NENI 20

Asambleja e Ortakut ka te drejte :

1. Te hartoje e miratoje ndryshimet ne Statut;
2. Te miratoje bilancin vjetor te shoqerise;
3. Te vendose per zmadhimin apo zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;

4. Te emeroje dhe shkarkoje administratorin e shoqerise;
5. Te shpalle prishjen, likuidimin dhe falimentimin e shoqerise;
6. Te shprehet per kohezgjatjen e shoqerise;
7. Te miratoje marreveshjet arritura ne qarkullimin civil te saj;
8. Te miratoje strukturat e shoqerise etj.;
9. Çdo vendim tjetër që i njihet nga ligji, Akti i Themelimit të shoqerise dhe Statutit të saj.

Proces verbalet e mbledhjeve ruhen ne seline e shoqerise.

Te drejttat e Administratorit

NENI 21

Administratori ka keto te drejttat:

1. Te perfaqesoje shoqerine ne marredheniet e saj me te tretet, ne administraten publike e ne organet gjyqesore;
2. Te emeroje prane shoqerise personelin e domosdoshem qe i nevojitet asaj ne permbushjen e aktivitetit tregtar dhe ekonomik;
3. Te paraqese per miratim ne Asamblene e Ortakut strukturen e brendshme organizative te shoqerise me emra perkates dhe te permbushe te gjitha detyrimet ligjore qe rrjedhin nga legjislacioni i punes Republikes se Shqiperise;
4. Te administroje pasurine dhe mjetet financiare te shoqerise brenda kufijve te caktuara nga Asambleja e Ortakut;
5. Te testoje aftesite e punonjesve ne administrate;
6. Te therrase Asamblene e Ortakut dhe te propozoje çeshtjet qe duhen analizuar;
7. Te hartojte objektivat e shoqerise per çdo vit pasues dhe te vendose e te ndjeke realizimin e detyrave te lena nga Vendimet e marra nga Ortaku;
8. Te hartojte planet e llogarive ekonomike dhe t'i paraqese ato per miratim nga Asambleja e Ortakut.

NENI 22

Administratori eshte pergjegjes individualisht sipas rastit ndaj vete shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te Statutit apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

NENI 23

1. Shoqeria "RXH GENERAL SERVICES" sh.p.k, emeron Ekspert Kontabel te Autorizuar.
2. Per emerimin, kompetencat, detyrimet, pergjegjesite, zevendesueshmerine, terheqjen, shkarkimin dhe shperblimin e tij zbatohet legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

Marredheniet e Punesimit

NENI 24

1. Te gjithë personat qe do te punesohen prane kesaj shoqerie, punesimi i tyre do te behet mbi bazen e kontrates individuale apo kolektive, sipas rastit, ne te cilen do te percaktohen te drejttat dhe detyrimet ligjore te seciles pale si dhe paga mujore ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne kete fushe.
2. Marrja ne pune behet me rregjistrimin nga punedhenesi ne Librin e Punes se Shoqerise, si dhe duke njoftuar organet e Punes se Juridiksionit ku ushtron aktivitetin Shoqeria.
3. Ndryshimi dhe largimi nga vendi i punes, behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Administratori. Largimi lidhet me mbarimin e kontrates se punes per shkak te shkeljeve disiplinore ose me kerkesen e te interesuarit.
4. Mosmareveshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se Shoqerise, do te zgjidhen me mirekuptim te paleve, te cilat per kete qellim mund te caktojne nga nje perfaqesues me prokure. Kur mirekuptimi nuk eshte i mundur, palet i drejtohen Gjykates te Rrethit Gjyqesor.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 25

Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut do te aplikohet Ligji "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe Legjislacioni Shqiptar ne fuqi.

NENI 26

Ky Statut hyn ne fuqi dite e regjistrimit te shoqerise ne Rregjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit.

NENI 27

Ky Statut perpilohet ne 2 (dy) kopje origjinale secili me te njejten vlere ligjore. Njeri prej tyre ruhet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Ortaku Themelues

Nuriana Isufi

Nuriana Isufi



Tirane me 01.04.2021